



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA FINANSIJE - MINISTRY
OF FINANCE

**NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA**

RAPORTI VJETOR

2011

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
Akronimet	3
Mesazhi i Drejtorit.....	4
Hyrje	5
PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË PËRGJITHSHME TË NJIF-K-së PËR VITIN 2011	6
PËRMBLEDHJE E RAPORTEVE TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË TË RAPORTUARA NË NJIF (RTD) DHE RAPORTET E INTELIGJENCËS TË DËRGUARA TEK INSTITUCIONET E NDRYSHME PËR VITIN 2011	7
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME TRANSAKSIONET E RAPORTUARA NGA TË GJITHË OBLIGUESIT NË NJIF-K GJATË VITIT 2011.....	8
INSPEKTIMI DHE MBIKËQYRJA	18
INTENSIFIKIMI I BASHKËPUNIMIT ME SUBJEKTET RAPORTUESE.....	18
NGRITJA E KAPACITETEVE TE SISTEMIT PER PARANDALIMIN E SHPERLARJES SE PARASE DHE FINANCIMIT TE TERRORIZMIT	19
Legjislacioni dhe propozimet	19
Udhëzimi administrativ Nr.014:	20
BASHKPUNIMET VENDORE DHE NDERKOMBETARE	20
Marreveshjet e Bashkpunimit.....	20
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR:.....	21
PROJEKTI ILECU	21
TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	22
Gjendja momentale e Sistemeve të Teknologjisë Informative	22
Prezantimi i softuerit për analiza goAML.....	23
Kapacitet e shtuara të IT-së:.....	24
EDUKIMI PROFESIONAL DHE TRAJNIMET.....	24
PERSONELI I NJESISË SË INTELIGJENCËS FINANCIARE.....	27

Akronimet

NJIF	- Njësia për Inteligjencë Financiare
QIF	- Qendra e Inteligjencës Financiare
PK	- Policia e Kosovës
MEF	- Ministria e Ekonomisë dhe Financave
ATK	- Administrata Tatimore e Kosovës
BQK	- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
UNMIK	- Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
EULEX	- Misioni i bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë
KFOR	- Misioni i NATO-s në Kosovë
PSRK	- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
FATF	- Task Forca e Veprimit Financiar
UNODC	- Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër drogës dhe krimit
ILECU	- Njesi Koordinuese për Zbatim të Ligjeve Ndërkombëtare
goAML	- Sistemi elektronik i këmbimit të dhënave
RTG	- Raporti i Transaksioneve të gatshme
RTD	- Raporti i Transaksioneve të dyshimta
AIF	- Raporti i informacioneve shtesë

Mesazhi i Drejtorit

Duke pasur parasysh që Kosova si shtet i ri është në zhvillim e sipër, edhe institucionet të cilat ndihmojnë në parandalimin veprimtarive që kërcënojnë zhvillimin ekonomik, sundimin e së drejtës, sigurinë, stabilitetin, janë në ndërtim e sipër. Kur flasim për institucione relativisht të reja, këtu bën pjesë edhe Njësia për Inteligjencë Financiare, institucion ky që është themeluar në bazë të ligjit mbi Parandalimin e Pastrimit të Parasë dhe Financimit të Terrorizmit.

Ligjit mbi Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit nr.03/L-196 është miratuar më datë 30 shtator 2010 dhe nga ky ligj është themeluar Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, si institucion qendror i pavarur kombëtar, përgjegjës për të parandaluar të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me shpëlarjen e parasë dhe financimin e terrorizmit.

Po ashtu vlen të theksohet se para miratimit të këtij ligji kane ekzistuar rregullore të njëpasnjëshme të UNMIK-ut të cilat kanë rregulluar funksionalizimin e një institucioni për pengimin e dukurisë së shpëlarjes së parasë. Më datë 1 mars të vitit 2004 është miratuar rregullorja 2004/2 e cila themelon institucionin Qendra e Informimit Financiar me përgjegjësi të plotë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të UNMIK-ut. QIF një kohë të gjatë ka vepruar vetëm me staf ndërkombëtar, pastaj ka filluar të punësojë një pjesë të stafit vendor dhe ka vazhduar deri në përfundimin e Misionit nga ana e UNMIK-ut. Pas ardhjes së misionit evropian EULEX, ky institucion kalon në kompetencë të plotë të këtij misioni të Bashkimit Evropian më datë 09 Dhjetor 2008.

Përpilimi i Raportit Vjetor të vitit 2011, është raporti i parë sa i përket informimit direkt institucioneve të Republikës së Kosovës rreth monitorimit të transaksioneve monetare si dhe të gjitha detajeve që në një mënyrë shfaqin dyshime lidhur me shpëlarjen e parasë dhe financimin e terrorizmit.

Lufta kundër shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit përbën një prioritet për qeverinë, jo vetëm pse Republika e Kosovës dëshiron të jetë anëtare e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, por edhe sepse ajo është pjesë e komunitetit ndërkombëtar institucionalisht të organizuar.

Sinqerisht,

Dardan NUHIU

Drejtor, Njësia për Inteligjencë Financiare

Hyrje

Krimi i pastrimit të parasë paraqet një kompleksitet të madh si në parandalimin e saj ashtu edhe në hetimin e tij. Ky lloj nuk njihet kufi dhe ka një ndikim negativ sistematik në shtetet demokratike, i cili për këtë arsye përpiket të organizohet dhe standardizohet në mënyrë institucionale për të luftuar atë. Për këtë qëllim, u krijua FAFT (Task Forca e Veprimet Financiar). Ajo është një organizatë ndërqeveritare që ndjekin udhëzimet e saj nga rreth 180 juridiksione në të gjithë botën, duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës.

Sipas ligjit nr.03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe në bazë të nenit 10 të këtij ligji , përpilohet raporti vjetor informues për Bordin Menaxhues të NJIF-K-së dhe përmban të gjitha informatat që kanë të bëjnë me NJIF-K-në sipas obligimeve të dala nga ky ligj.

Ky raport përpilohet dhe paraqet punën e bërë nga ana e QIF/NJIF-K-së prej muajit 1 Janar 2011 deri më 30 Dhjetor 2011 dhe paraqitet në këto pika:

- Faza fillestare dhe tranzicioni i NJIF-K-së;
- Sistemi organizativ i NJIF-K-së;
- Puna operationale;
- Aspekti i menaxhimit Financiar duke përfshirë të gjitha shpenzimet e NJIF-K-së;
- Bashkëpunimi Ndërkombëtar;
- Zhvillimi i Njesisë;

Sipas dispozitave ligjore mbi parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit do të paraqiten të gjitha raportet (të dhënat) statistikore mbi transaksionet e Kesh-it dhe transaksionet e dyshimta.

Statistikat e përgjithshme mbi mbledhjen e raporteve nga subjektet raportuese tregojnë se numri më i madh i raporteve është i pranuar nga ana e bankave si nga ana e raporteve të kesh-it (parasë se gatshme), po ashtu edhe nga transaksionet e dyshimta.

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË PËRGJITHSHME TË NJIF-K-së PËR VITIN 2011

Përmbledhja e raporteve tremujore gjatë vitit 2011 në një raport të përgjithshëm njëvjeçar është bërë për të bërë krahasimin e lëvizjeve të raportimeve të institucioneve financiare dhe gjendja e përgjithshme e përcjelljes së KESH-it nga NJIF-i duke e bërë publike gjendjen e qarkullimit të mjeteve financiare në territorin e Republikës së Kosovës.

Njësia për Inteligjencë Financiare, është njësi përgjegjëse për pranimin dhe analizimin e Raporteve të Aktivitetit të dyshimtë, raporteve tjera të ndryshme dhe informacioneve të siguruara nga subjektet raportuese, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencioni Kadastral dhe zyrave tjera relevante komunale dhe agjencioneve të zbatimit të ligjit (vendore dhe ndërkombëtare) që operojnë në Kosovë dhe shpërndan rezultatet nga analizat tek institucionet relevante për qëllime të inteligjencës apo për aktivizimin në hapa të nevojshëm të hetimit. NJIF po ashtu është përgjegjës për bashkëpunim ndërkombëtar me organet e jashtme të cilat kryejnë veprimtarinë e ngjashme në fushën e luftës kundër shpëlarjes së parave dhe financimit e terrorizmit.

Për qëllime të inteligjencës, NJIF ka krijuar dhe mirëmban bazën e të dhënave për informacionet e mbledhura.

Gjatë vitit 2011 janë raportuar gjithsej 423443 RTG¹ (Transaksione te gatshme, kesh) nga bankat, institucionet mikrofinanciare dhe Këmbimoret me vlerë totale prej 4,873,354,867 EUR ku ne këtë shume përfshihen raportet nga Dogana e Kosovës në lidhje me transaksionet në euro dhe valuta tjera (shumica ne USD, GBP, CHF dhe dinari serb) në lidhje me biznese dhe persona fizik, me vlerë totale prej 863,399,010.43 EUR.

¹RTG – Ashtu siç është e përcaktuar me nenin 22 të ligjitnr. 03/L-196 “Për parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe financimit e terrorizmit”, transaksionet kesh që duhet të raportohen në NJIF janë “të gjitha transaksionet në vlerë prej 10,000.00 € e më shumë. Transaksionet e shumëfishta do të trajtohen si një transaksion individual nëse banka ose institucioni financiar është në dijeni se transaksionet janë nga apo në emër të një personi ose subjekti dhe kapin vlerën prej më shumë se dhjetëmijë (10,000.00) euro brenda një dite të vetme.


PËRMBLEDHJE E RAPORTEVE TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË TË RAPORTUARA NË NJIF (RTD) DHE RAPORTET E INTELIGJENCËS TË DËRGUARA TEK INSTITUCIONET E NDRYSHME PËR VITIN 2011

Gjatë vitit 2011, NJIF-K ka hapur 146 raste RTD² (Transaksione te dyshimta), ku pas analizimit dhe përpunimit të tyre nga ana e zyrtarëve të NJIF-it ka rezultuar se për 114 raste ekziston dyshimi mbi pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe të njëjtat janë proceduar në institucionet përkatëse për zhvillim të procedurave të mëtutjeshme ligjore .

Në vijim paraqiten në formë tabelore rastet e proceduara në institucione të ndryshme duke përfshirë edhe kërkesat e institucioneve lidhur me rastet që kanë dyshim mbi pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit:

Policia e EULEX-it	26
Policia e Kosovës	39
Administrata Tatimore e Kosovës	12
KFOR	3
Prokuroria Speciale e Kosovës	2
Dogana e Kosovës	19
Interpoli, përmes EULEX-it (IPCU)	1
FIU Maqedoni- FYROM	3
FIU Shqipëri	2
FIU Mali i Zi	2
FIU Bosnja dhe Hercegovina	1
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1
Banka Qendrore e Kosovës	3
Total:	114

² RTD - Subjektet raportuese, përmes zyrtarëve të tyre të përputhshmërisë, duhet të raportojnë në NJIF të gjitha transaksionet të cilat mund të konsiderohen si të dyshimta dhe mund të kenë lidhje me shpëlarjen e parave, financimin e terrorizmit dhe/ose veprave të tjera penale, në bazë të disa listave të indikatorëve të cilat u janë ofruar bankave.



Në figurën e mësipërme shihet se numri më i madh i raporteve të inteligjencës që kanë rezultuar nga pranimi, mbledhja dhe përpunimi i informacioneve në lidhje me dyshimet për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit gjatë vitit 2011 janë dërguar tek Policia e Kosovës, pastaj tek Policia e EULEX-it dhe me radhë tek institucionet tjera.

TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME TRANSAKSIONET E RAPORTUARA NGA TË GJITHË OBLIGUESIT NË NJIF-K GJATË VITIT 2011.

Ne vitin 2011 ne NJIF-K janë raportuar gjithsej **358,234** raporte për transaksionet e kryera nga bizneset ku pjesa më e madhe është e raportuar nga Bankat dhe pjesa tjetër nga Dogana (Shih tabela 1 dhe 2).

Gjatë analizimit të numrit të raporteve dhe duke krahasuar me periudhat tre mujore, kemi parë se është shënuar rritje e raportimeve për biznese gjatë muajve me radhë në vitin 2011. (Shih grafikun 1)


Biznese	Viti 2011
Banka	357204
Ins. Mikrofinanciare	0
OJQ	0
Këmbimoret	0
Dogana	1030
Total:	358234

Tabela nr.1

Numri i RTG- ve2011

Biznese	Tremujori1	Tremujori2	Tremujori 3	Tremujori 4
	70840	92098	99099	96197

Tabela nr.2



Grafiku nr.1

Njësia për Inteligjencë Financiare gjatë vitit 2011 ka pranuar 65,209 raporte të parasë së gatshme (keshit) për persona fizik dhe pjesa më e madhe është raportuar nga Bankat, Këmbimoret, Dogana dhe institucionet Mikrofinanciare. (Shih tabela 3 dhe 4)


Persona	Viti 2011
Banka	62942
Ins. Mikrofinanciare	3
OJQ	0
Këmbimoret	1492
Dogana	772
Total:	65209

Tabela nr.3

Numri i RTG-ve sipas tremujorëve

Persona	remujori1	Tremujori2	Tremujori 3	Tremujori 4
	11880	16998	19685	16646

Tabela nr.4




Grafiku nr.2

**Numri total RTG-ve për
Biznese dhe Persona**

Tremujori 1	Tremujori 2	Tremujori 3	Tremujori 4
82720	109096	118784	112843

Tabela nr. 5




Grafiku nr.3

Siç shihet në Tabelën 5 dhe Grafikon 3 , numri total i raporteve të gatshme (kesh mbi 10,000.00 euro) në lidhje me biznese dhe persona (individ) fizik të raportuara në NJIF-k nga bankat dhe institucionet tjera financiare gjatë vitit 2011 shënon rritje nga tremujori i parë i këtij viti, duke shënuar kështu rritjen më të madhe gjatë muajve korrik, gusht, shtator të vitit 2011, përkatësisht tremujorit të tretë të vitit 2011.


Vlerat (Shuma) e RTG (Raportet e të gatshmeve) nga subjektet raportuese për biznese:

Biznese	Viti 2011
Banka	2,953,482,647.85
Ins.	0
Mikrofinanciare	
OJQ	0
Këmbimoret	0
Dogana	845,931,226.88
Total:	3,799,413,874.73

Tabela nr.6



Grafiku nr.4



Grafiku nr. 5

Në Tabelën nr.6 dhe Grafiku nr.4 paraqitet pasqyra ku shihen vlerat (ne Euro) e RTG-ve (Raporteve të gatshme) në lidhje me subjektet e biznesit. Siç mund ta vërejmë, vlerat më të mëdha arrijnë raportet e dërguara në NJIF nga Bankat komerciale ku zë vend dhe Dogana e Kosovës të cilat përcjellin lëvizjen e mjeteve monetare të gatshme (kesh) në të gjitha pikëkalimet kufitare në vend. Një ngritje e numrit te raportimeve vërehet gjate muajve korrik dhe gusht dhe është e paraqitur në grafikun nr.5.

Vlerat e RTG (Raportet e të gatshmeve) nga subjektet raportuese për persona fizik

Persona (individ)	Viti 2011
Banka	968,870,323.59
Ins. Mikrofinanciare	63,593
OJQ	0
Këmbimoret	37,539,292.14
Dogana	17,467,783.55
Total:	1,023,940,992.28


Tabela nr.7

Sa i përket raportimit të vlerave të RTG-ve në lidhje me persona (individ), këtu për dallim nga ato në lidhje me biznese, shihen vlera të RTG-ve të raportuara në NJIF edhe nga institucione tjera financiare (Këmbimoret dhe Ins. Mikrofinanciare), mirëpo nuk ka ndonjë vlerë që është raportuar nga ndonjë Organizata Joqeveritare (OJQ) si vlerë e RTG-së.


Vlerat (Shuma) RTG-ve
2011

Persona	Tremujori 1	Trem jori 2	remujori 3	Trem jori 4
	205,106,117.00	251,944,599.00	305,707,628.55	261,182,647.73

Tabela nr.8



Grafiku nr. 6




Grafiku nr. 7.

Sa i përket uljes apo ngritjes së vlerave të RTG-ve të raportuara në NJIF-K në aspekt kohor gjatë vitit 2011, në tab. nr.8 dhe Grafikon 6 dhe 7 vërehet se në tremujorin e tretë, përkatësisht gjatë muajve korrik, gusht, shtator 2011, raportimi i RTG-ve ka pasur nivelin më të lartë të shprehur në mjete monetare (vlera në para).

Transaksionet bankare në kesh (të gatshme)

Viti	Lloji i Biznese transaksionit	Persona	Total	
2011	Deponime	2,130,392,091	519,612,398	2,650,004,489
	Tërheqje	823,090,559	424,071,817	1,247,162,376

Tabela nr.9




Grafiku nr.8

Figura e mësipërme na tregon numrin total të transaksioneve të kryera (deponime dhe tërheqje në kesh, baras ose mbi 10,000.00 euro) gjatë vitit 2011 nga personat fizik dhe subjektet biznesore të raportuara në NJIF-K nga subjektet raportuese sipas ligjit në fuqi. Siç vërehet numri më i madh i këtyre transaksioneve u përket bizneseve të ndryshme dhe deponimet janë lloji më i shpeshtë i transaksioneve që kryhen.

Transaksionet në të gatshme (kesh) në valuta të huaja në banka dhe këmbimore

Valuta	Bankat	Këmbimore	Total
CAD	19, 60	0	19,260
CHF	386,720,811	45,375,555	432,096,366
RSD	771,117,816	105,320,276	876,438,092
GBP	7,518,489	733,734	8,252,223
HRK	31, 44	19,540	50,684
NOK	109,248	0	109,248
SEK	276,690	0	276,690
USD	125,871,986	12,075,063	137,947,049
AUD	19, 00	0	19,600
DKK	8,800	0	8,800

Tabela nr.10




Grafiku nr.9

Deklarimet e në të gatshme (keshit) nga Dogana e Kosovës

Valuta	Biznese	Persona fizik	Total
CAD	269,990.00	0	269,990.00
CHF	245,932,600.00	6,208,590.00	252,141,190.00
RSD	2,886,617,240.00	0	2,886,617,240.00
GBP	4,793,500.00	0	4,793,500.00
HRK	449,595.00	0	449,595.00
NOK	3,243,850.00	0	3,243,850.00
SEK	1,657,600.00	0	1,657,600.00
USD	21,157,100.00	679,494.00	21,836,594.00
EUR	389,946,225.00	11,750,671.00	401,696,896.00
AUD	76,370.00	0	76,370.00
ALL	0	1,440,350.00	1,440,350.00
DKK	1,632,350.00	0	1,632,350.00
HUF	184,000	0	184,000

Tabela nr. 11



Grafiku nr.10

Dogana e Kosovës sipas nenit 29 të ligjit 03/L-196, “Mbi parandalimin shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit”, detyrohen të raportojnë në NJIF secilin person fizik dhe juridik (biznese) që deklarohet se fut brenda Kosovës apo nxjerrë jashtë saj, mjete në kesh në vlerë që tejkalon shumë prej 10,000.00 euro. Figurat e mësipërme (Tab. nr.10,11 dhe grafiku nr.9,10)

na epin të dhëna në lidhje me deklaratimet në kesh nga individ dhe subjekte biznesore në valuta të ndryshme, ku shihet qartë se numri më i madh i deklaratimeve vjen nga bizneset.

INSPEKTIMI DHE MBIKËQYRJA

Gjatë tremujorit të parë 2011, në proces ishin katër raste të inspektimit të pajtueshmërisë, katër tjera ishin iniciuar në të njëjtën kohë, përderisa gjashtë raste ishin mbyllur nga inspektorët e NJIF/QIF-it gjatë kësaj periudhe, përderisa deri më 31 mars, dy raste ishin ende të hapura. Te gjitha inspektimet e iniciuara ishin në lidhje me OJQ-të, përkatësisht institucionet mikrofinanciare.

Gjatë tremujorit të dytë 2011, është përmirësuar përputhshmëria e subjekteve në raport me obligimet ndaj luftës kundër shpëlarjes së parave. Kjo është bërë me komunikim dhe takime të rregullta me institucionet financiare. Për shkak të mungesës së personelit në NJIF, gjatë kësaj periudhe raportuese nuk ka qenë e mundur të kryhen inspektime të pajtueshmërisë.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, në proces ishin filluar dy inspektime të pajtueshmërisë me ligjin dhe dy të tjera janë iniciuar. Inspektimet e iniciuara kanë të bëjnë me biznese private. Ndërsa, ky aktivitet është kryer pjesërisht gjatë tremujorit të katërt 2011, për shkak të zbrazëtirës ligjore në ligjin e ri. NJIF është fokusuar më shumë në tregtarët e automjeteve dhe agjencioneve për shitblerje të patundshmërive.

INTENSIFIKIMI I BASHKËPUNIMIT ME SUBJEKTET RAPORTUESE

Kontaktet me subjektet raportuese janë forcuar në mënyrë që ato të informohen në mënyrë të rregullt në lidhje me zbatimin e obligimeve nga ana e tyre sipas ligjit në fuqi dhe të ndihmohen ato që të jenë në përputhje me rregullat. Për këtë arsye, janë zhvilluar inspektimet e pajtueshmërisë me ligjin më qëllim që të udhëzohen subjektet e inspektuara se si të operojnë për të respektuar dispozitat ligjore për luftë kundër shpëlarjes së parave. Për më tepër, NJIF ka mbajtur takime të rregullta më zyrtarët e përputhshmërisë brenda bankave, në mënyrë që të garantohet zbatimi i vazhdueshëm i obligimeve ligjore dhe udhëzimet administrative të NJIF-it kundër shpëlarjes së parave.

Arritje e veçantë është bërë gjatë kësaj periudhe raportuese, e cila është pjesë e përpjekjeve tona që t'i lidhim të gjitha subjektet raportuese që të raportojnë në NJIF në mënyrë elektronike. Agjencionet e transfereve të parave (remitancave) tani raportojnë në NJIF në mënyrë elektronike përmes sistemit elektronik të këmbimit të informatave goAML, duke eliminuar kështu nevojën për përdorimin e letrave dhe njëkohësisht duke e rritur shkallën e sigurisë dhe efikasitetit në këmbimin e informacioneve.

NGRITJA E KAPACITETEVE TE SISTEMIT PER PARANDALIMIN E SHPERLARJES SE PARASE DHE FINANCIMIT TE TERRORIZMIT

Legjislacioni dhe propozimet

Njësia për Inteligjencë Financiare (QIF apo NJIF) gjatë vitit 2011 ka qenë e angazhuar maksimalisht për ndryshimet ligjore , në mënyrë që ligji të përafrohet me standardet e Bashkimit Evropian.

Si pasojë e ndryshimit në legjislacionin kundër pastrimit të parave, e cila jep më pak autoritet për NJIF-in në lidhje me inspektimet e bankave, NJIF është në përgatitje e sipër të propozimeve për amandamentim dhe plotësim të ligjit 03/L-196 te cilat amandamentime do te krijonin standardizim te këtij ligji me ligjet e BE-se. NJIF ka krijuar grupin punues, duke përfshirë drejtorin dhe analistët për të rishqyrtuar legjislacionin në lidhje me pastrimin e parave, identifikimin e mospërputhjeve dhe propozimin e amendamenteve për të qenë në përputhje me 40+9 rekomandimet e FATF apo TFVF-së (Task Forca e Veprimit Financiar) dhe standardet tjera ndërkombëtare.

Janë identifikuar deri më tani disa mangësi, duke përfshirë edhe uljen e autoritetit të NJIF-it për të pasur mundësi në kryerjen e inspektimeve të bankave në lidhje me pajtueshmërinë me ligjin. Po ashtu, janë identifikuar edhe dispozita ligjore të paqarta në lidhje me identifikimin e klientit dhe ruajtjen e shënimeve, obligimet e kazinove si dhe dispozita të paqarta ligjore për bizneset të cilat përfshihen në transaksione në të gatshme në vlerë prej 10,000 € e më shumë.

Njësia për Inteligjencë Financiare së bashku me kolegët ndërkombëtarë të Qendrës së Inteligjencës Financiare (Shkrirja nga QIF ne NJIF – lexo më lartë) kanë bërë angazhime rreth zbulimit të metave që ka sistemi i përgjithshëm, që nënkupton përmirësimin dhe rregullimin e sistemit për parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit në Republikën e Kosovës.

Një ndër hapat më të rëndësishëm ka qenë aplikimi i sistemit për kontrollimin e transfereve në mënyrë elektronike që me këtë sistem ulet ndjeshëm rreziku ndaj këtyre transaksioneve me të cilat mund të financohet terrorizmi dhe pastrimi i parasë.

Udhëzimi administrativ Nr.014:

Në sajë të konsultimeve me bankat të cilat operojnë në Kosovë, NJIF ka lëshuar udhëzimin administrativ si pasojë e lëshimeve dhe zbrazësive të vazhdueshme ligjore në lidhje me raportimin, sidomos me atë që ka të bëjë me plotësimin në mënyrë të saktë të fushave (kolonave), ashtu siç parashihet me skemën goAML 3.1.

Duke u bazuar në udhëzimin administrativ nr. 014, nga data 06/12/2011, është e obligueshme të plotësohet fusha apo kolona “Transaction_description”, apo përkthyer në gjuhën shqipe “përshkrimi i transaksionit”, ashtu siç jepet nga ana e klientit, të cilin përshkrim e shënon arkëtari për të ekzekutuar kërkesën e klientit.

BASHKPUNIMET VENDORE DHE NDERKOMBETARE

Marrëveshjet e Bashkëpunimit

Paralelisht, në kuadër të NJIF-K si përfaqësues/ koordinator i veprimit kundër shpëlarjes së parasë/financim të terrorizmit , grupet e punës me objektiva të veçanta janë krijuar dhe përbërë nga profesionistë të NJIF-it dhe agjencive me përgjegjësi në Luftën kundër SH.P / F.T. Këto grupe do të funksionojnë plotësisht gjatë vitit 2012 ,ku për këtë qëllim, zyrtarë të NJIF-it zhvillojnë takime me përfaqësues nga të gjitha Agjencitë Kombëtare përkatëse në zbatimin e politikës kundër veprave penale ndaj ekonomisë përkatësisht korrupsionit, për qëllimet e koordinimit të veprimeve dhe planifikimit të strategjisë për forcimin e sistemit.

NJIF ka vazhduar që të bashkëpunojë intensivisht me FIU të huaja në aspekt të shkëmbimit të informatave, sidomos me ato institucione të huaja ku NJIF ka memorandume bashkëpunimi.

Gjatë vitit 2011 NJIF ka pranuar kërkesa për informata nga njësi për verifikim nga Këshilli Gjyqësor në mënyrë që të asistojë njësinë e verifikimit financiar pranë këtij institucioni në verifikimin e të dhënave financiare të kandidatëve që aplikojnë për

gjyqtarë. Deri më 31 dhjetor 2011, NJIF ka kompletuar 210 verifikime të së kaluarës për këta kandidatë dhe këto informata i ka dorëzuar në Këshillin Gjyqësor.

NJIF po ashtu ka të nënshkruara memorandume të bashkëpunimit me shtete të huaja si në vijim:

Shteti	Institucioni
Shqipërinë	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave
Maqedoninë	Drejtoria për parandalimin e pastrimit të parasë
Malin e zi	Administrata për parandalimin shpëlarjes së Parasë
Kroacia	Zyra kundër shpëlarjes së parave
Sllovenia	Zyra për parandalimin e pastrimit të parasë
San Marino	Agjencia e Inteligjencës Financiare
Bullgaria	Drejtoria e Inteligjencës Financiare e Agjencisë për siguri kombëtare

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR:

PROJEKTI ILECU

Mbështetja e Bashkimit Evropian ka vazhduar edhe gjatë vitit 2011, ku NJIF-K është bërë pjesëmarrëse dhe ka caktuar një zyrtar të përhershëm në projektin rajonal ILECU që si synim është krijimi i njëjësive koordinuese Kombëtare që ndikon në formën e bashkëpunimit institucional në luftën kundër krimit të organizuar. Qëllimi apo misioni i ILECU është shkëmbimi i informacionit në nivel ndërkombëtar .

Njësia për Inteligjencë Financiare në fund të vitit 2011 ka bërë të mundur lidhjen e komunikimit përmes këmbimit elektronik të informatave në mënyrë të enkriptuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave nga Republika e Shqipërisë dhe të njëjtën procedurë do të zhvillojë me të gjitha shtetet që ka marrëveshje bashkëpunimi.

NJIF-K në mënyrë aktive ka kërkuar partnerë të huaj për mbështetje në anëtarësim në EGMONT Group. Autoritetet sllovene kanë dhënë përgjigje pozitive në lidhje me këtë çështje dhe negociatat joformale kanë filluar. Hapi i parë në drejtim të anëtarësimit pritet të bëhet gjate vitit 2012, fillimisht duke ndryshuar procedurat ligjore dhe duke ju përshtatur rregullave të FATF, pastaj plotësimi i përgjithshëm i pyetësorit për arritjen apo plotësimin e kushteve të kërkuara me standarde ndërkombëtare dhe kur FIU nga Sllovenia të pranojë zyrtarisht që të bëhet “sponsor” i NJIF-it dhe zyrtarisht t’i kërkojnë sekretariatit të EGMONT-it që NJIF-it t’i mundësohet aplikimi në këtë organizate.

Duke pasur parasysh rëndësinë e të qenit anëtarë i këtij grupi i cili në takimet e veta këshillon dhe bart përvoja të ndryshme ndërkombëtare, që ndikon direkt në cilësinë e punës operacionale të secilës Njësi. Grupi Egmont është një organizatë ndërkombëtare, e cila bashkon agjencitë qeveritare, në thelb Njësitë e Inteligjencës Financiare (NJIF), duke krijuar një rrjet ndërkombëtar për shkëmbimin e informacionit, njohurive dhe të teknologjisë në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Gjendja momentale e Sistemeve të Teknologjisë Informative

Njësia për Inteligjencë Financiare posedon një sistem të avancuar të Teknologjisë Informative. Sistemi përbëhet nga dy pjesë kryesore:

- Sistemit të sigurte (të mbyllur) të Teknologjisë Informative
- Sistemit të Internetit (të hapur) të Teknologjisë Informative

Në sistemin e sigurte të Teknologjisë Informative bëjnë pjesë : Aplikacioni GoAML ,Firewall, switch at, Server et, Databazat tjera (IBASE, FIDOC, Baza e të dhënave të logjistikës, Avast, Device Lock), Kompjuterët, Printerët, Skanerët,etj.

Prezantimi i softuerit për analiza goAML

Softueri goAML është zhvilluar nga Kombet e Bashkuara (UN Office on Drugs and Crime), i cili shërben për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave financiare dhe ndihmon menaxhmentin në menaxhimin e rasteve. Bankat tani nëpërmjet sistemit goAML dërgojnë në NJIF raporte shtesë të transaksioneve (AIFs) ashtu siç kërkohet me udhëzimin administrativ nr. 010 dhe 013 të lëshuar paraprakisht nga QIF. Ky hap e ka avancuar dhe e ka bërë më efektive punën analitike të Institucionit dhe e ka reduktuar përdorimin e letrave.

GoAML është sistem i avancuar i Teknologjisë Informative përmes të cilës bëhet: Analiza ,Raportimi dhe Shkëmbimi i të dhënave financiare nga obliguesit e NJIF-it.

Për momentin është arritur të implementohet në tërësi duke përfshirë :

- Raportimin e sigurve(CTR,STR,AIF) përmes GOAML të Bankave dhe Mikrofinancave
- Analiza komplete përmes GOAML të rasteve të dyshimta të pastrimit të parave
- Përmes website të NJIF-it (GOAML) është arritur të krijohet mundësia e shkëmbimit të sigurve të informacioneve në mes NJIF-it dhe Agjencioneve tjera të cilat janë të obliguara të përgjigjen në kërkesat e NJIF-t.
- Sigurim komplet i Harduerit të nevojshëm për funksionimin e GoAML sipas standardeve më të larta(përmes buxhetit të Kosovës).
- Implementimi i plotë politikave të sigurisë së Teknologjisë Informative të nxjerra nga NJIF-i me qëllim të monitorimit dhe mbrojtjes së të dhënave të besueshme bazuar në standardet më të larta evropiane.

Në sistemin e internetit të Teknologjisë Informative bëjnë pjesë : Aplikacioni GoAML , Firewall, switch-at, Serveri (UBUNTU-Linux, Avast), Kompjuterët, Printerët, Uebsajti, Email zyrtar ,etj.

Edhe ky sistem është ndërtuar në bazë të standardeve evropiane në fushën e sigurisë dhe ka të implementuar sistemin e qasjeve të kufizuara në internet.

Bankat tani nëpërmjet sistemit goAML dërgojnë në NJIF raporte shtesë të transaksioneve (AIFs). Sistemi poa shtu siguron një kanal të sigurtë komunikimi ndërmjet NJIF-it dhe subjekteve raportuese si dhe agjencioneve tjera të zbatimit të ligjit siç janë Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Në sajë të procesit të tranzicionit dhe fazës së rekrutimit të stafit të ri vendor para dorëzimit të institucionit, në fillim të vitit 2012 është planifikuar të mbahet një kurs në lidhje me sistemin goAML nga ana e ekspertëve nga UNODC nga Vjena.

Kapacitet e shtuara të IT-së:

NJIF është në fazën e përfundimit të projektit për përmirësimin e kapaciteteve të IT-së dhe kështu në mënyrë të konsiderueshme ka shpejtuar softuerin e analizave, të cilin e përdorin analistët e inteligjencës.

Si rezultat i këtij përmirësimi, softueri goAML tani operon me kapacitet procedimi **30%** më të lartë dhe RAM memoria është rritur për **50%**.

Për më tepër, është instaluar edhe solucioni i ri për *backup* (ruajtje dhe rikthim të informatave), prandaj NJIF tani plotëson kriteret në lidhje me ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave.

EDUKIMI PROFESIONAL DHE TRAJNIMET

Me qëllim të ngritjes së mëtutjeshme profesionale për punë më efikase në luftë kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, stafi i NJIF-it së bashku me punonjës tjerë të agjencioneve të ndryshme të zbatimit të ligjit ka ndjekur trajnime të ndryshme. Personeli i NJIF-it ka marrë pjesë në disa trajnime të organizuara nga institucionet vendore e ndërkombëtare.

Njësia e Inteligjencës Financiare është përqendruar në trajnimin e stafit dhe ngritjen e vetëdijes së shoqërisë, me anë të aktiviteteve informuese dhe formave tjera të përcaktuara me ligj.

Si rezultat i zbatimit të një politike të vazhdueshme të trajnimit, të gjithë anëtarët e NJIF-it kanë marrë pjesë në aktivitete trajnuese gjatë vitit 2011, në disa nga këto

aktivitete, anëtarët e stafit kanë ligjëruar për obliguesit ligjor si dhe institucionet e zbatimit të ligjit .

Profesionistët NJIF-it kanë marrë pjesë si trajnues në seminarët e organizuara brenda vendit. Trajnimet kanë qenë organizuar në Republikën e Kosovës dhe ekspertët e huaj të cilët ishin të pranishëm prezantuan shkëmbimin e njohurive dhe ekspertizës në fushën Kundër shpëlarjes të parasë/Financim të Terrorizmit .

Në kuadër të nismave të ndërmarra, vlen të përmenden ngjarje të mëposhtme në të cilat njësia ka marrë pjesë.

Numri i pjesëmarrësve nga NJIF	Trajnimi	Data fillimit	e Data mbarimit	e Organizuar nga	Lokacioni
2	Procedurat e Prokurimit dhe Tenderimit	15/04/2011	15/04/2011	OSCE	QKSPEZH
1	Kontabilitet	01/01/2011	/	SCAAK	SCAAK
2	Teknikat e hetimeve financiare	21/10/2011	28/10/2011	OTA (Thesari i SHBA-së)	ICITAP
3	Punëtori në lidhje me konfiskimin e asetëve	09/11/2011	10/11/2011	TAIEX	TAIEX
1	Moduli i çertifikuesit të shpenzimeve publike SIMFK	14/11/2011	17/11/2011	MEF	MEF
1	Moduli i shpenzimeve publike SIMFK	14/11/2011	22/11/2011	MEF	MEF
3	Teknikat e analizave financiare	05/12/2011	09/12/2011	OTA	ICITAP
3	Pastrimi i parave bazuar në tregti	31/01/2012	01/02/2012	OTA	ICITAP

Po ashtu vlen të ceket se gjatë vitit 2011, nga Njësia për Inteligjencë Financiare është kërkuar që të ofrohen orë ligjërimi në lidhje me Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, në mënyrë që t’u prezantohet puna, struktura dhe mandati i QIF-it, agjencioneve tjera të zbatimit të ligjit si Policisë së Kosovës, Doganës, Administratës Tatimore dhe zyrës së Prokurorit. Në lidhje me këtë, NJIF ka ofruar ligjërues në trajnimet si në vijim:

Nr. i Ligjëruesve	Trajnimi	Data	Organizuar nga
2	Ligji, “Për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit”	08/03/2011	NJIF, ICITAP& OTA
1	Qarkullimi i parasë së gatshëm,e - Doganat e Kosovës	15/06/2011	OTA
1	Teknikat e hetimeve financiare	26/04/2011	OTA
2	Trajnimi mbi hetimet financiare	14/09/2011	KCPSED
1	Trajnimi i avancuar mbi luftën e krimit ekonomik	15/11/2011	OSCE
1	Ligji, “Për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit”	15/09/2011	DMTH Sh.p.k., (Money Gram)

PERSONELI I QENDRES SE INTELIGJENCES FINANCIARE/ NJESISË PËR INTELIGJENCË FINANCIARE

Pasi që Qendra e Inteligjencës Financiare është krijuar nga misioni i Kombeve të Bashkuara UNMIK-u në vitin 2004, i tërë personeli i punësuar ka qenë ndërkombëtar. Bartja e përgjegjësive nga UNMIK-u tek misioni i Bashkimit Evropian EULEX ka rezultuar edhe me bartjen e këtij institucioni. Organizimi i QIF-it nga ana e ndërkombëtarëve vijon si më poshtë:

Në fund të vitit 2011, struktura e personelit të QIF-it paraqitet si në vijim :

- | | |
|-------------------------|--------------------------------------|
| 1) Staf i EULEX-it | 9 (7 ndërkombëtar dhe dy staf lokal) |
| 2) Staf vendor (lokal) | 14 Shërbyes civil të Kosovës |
| 3) Staf vendor sekondar | 1 staf lokal |

Stafi lokal që është i cekur në strukturën e QIF-it do të bartet së bashku me përgjegjësitë nga QIF në NJIF.

Struktura: Drejtori (1), ekspertë të IT-së (2) – Menaxher i bazave të dhënave dhe menaxher i rrjetit, Analistë të Inteligjencës (4). Për arsye organizative, njëri nga analistët ushtron detyrën e zv.Drejtorit dhe në të njëjtën kohë ushtron edhe detyrën e analistit.

Stafi lokal në përbërje të EULEX-it: Asistent Administrativ/Përkthyes (2), njëri shqiptar dhe tjetri serb.

Me formimin e Njësia për Inteligjencë Financiare dhe caktimin e drejtorit të kësaj njësie, ka filluar bartja e përgjegjësive nga EULEX-i tek autoritetet vendore dhe përfundimi i këtij tranzicioni do të jetë më 1 Qershor 2012. Njësia për Inteligjencë Financiare paraqet këtë strukturë:

Struktura: Drejtori i NJIF-it (1), menaxher i IT-së (1), zyrtar ligjor (1), zyrtar për buxhet dhe financa (1), zyrtar i prokurimit (1), asistent administrative (1) dhe analistë të inteligjencës (8).

Zyrtar i Doganës (1), zyrtar nga Administrata Tatimore e Kosovës (1).